

D E K R E T
Nr.7468, datë 22.2.1991

PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT PRESIDENCIAL

Duke marrë parasysh gjendjen e rëndë politike dhe ekonomike të krijuar ditët e fundit për shkak të disa veprimeve vandaliste e pa përgjegjësi, që kanë krijuar vështirësi edhe në qeverisjen e vendit dhe në ruajtjen e rendit publik, me qëllim që të mbrohen liria, pavarësia dhe sovraniteti kombëtar dhe të sigurohet drejtimi shtetëror mbi bazën e unitetit të popullit;

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës;

PRESIDIUMI I KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

1.Të krijohet Këshilli Presidencial pranë Kryetari të Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

2.Këshilli Presidencial ka për detyrë që të shqyrtojë çështjet më të ngutshme për kapërcimin e vështirësive të krijuara nga gjendja e rëndë politike dhe ekonomike, duke propozuar marrjen e masave të duhura dhe nxjerrjen e akteve përkatëse.

3.Këshilli Presidencial përbëhet nga këta anëtarë:

1.Fatos Nano, kryeministër, bashkëpunëtor i vjetër shkencor.

2.Kleanthi Koçi, kryetar i Gjykatës së Lartë.

3.Kiço Blushi, shkrimtar.

4.Haxhi Lleshi, ish-kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor.

5.Luftar Xhuveli, Profesor, Doktor i Shkencave.

6.Rexhep Mejdani, Profesor, Doktor i Shkencave.

7.Millena Dalani, gazetar.

8.Xhenet Muço, ushtarak.

4.Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI
SIHAT TOZAJ

KRYETARI
RAMIZ ALIA